



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.662/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Adnan Konushevci dhe Rrustem Thaqi anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e Dusan Milunovic nga rradhët e Subjektit politik G.I. Serpski Opstanak, dega në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, me objekt të çështjes, verifikim i rezultateve, rinumrim i të gjitha vendvotimve në pjesën Veriore të Mitrovicës, Për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.662/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Dusan Milunovic nga Subjekti politik G.I. Serpski Opstanak, për shkak të verifikim të rezultateve në 23 (njetzet e tri) vendvotime në Mitrovicën e Veriut, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.662/2021 nga Dusan Milunovic nga Subjekti politik G.I. Serpski Opstanak, në të cilën theksohet se gjatë ditës së zgjedhjeve në Mitrovicën Veriore, pati shkelje drastike të rregullave zgjedhore, prandaj është e nevojshme të vërtetohet secila situatë veç e veç, është e nevojshme të rinumërohen votat në 23 vendvotime. Vendvotimet e numëruara janë ato që ne i kemi renditur dhe sipas deklaratave të subjekteve të tjera politike, konkretisht anëtarëve të tyre në qendrat e votimeve, votat e GI Srpski Opstanak, u numëruan dhe nuk u përfshinë në rezultatin përfundimtar, por në shumicën e rasteve ato u shpallën të pavlefshme. Ju njoftojmë gjithashtu se ne nuk kishim asnjë kandidat në listë për këshilltarë, por se vetëm bartësi i listës garoi. Ka pasur fletvotime në të cilat votuesit shënuan

katrorin nga ana e djathtë, dhe ato fletëvotime u shpallën të pavlefshme, edhe pse sipas rregullave, ato shkojnë te bartësi i listës.

Si deshmi ankeses i ka bashkangjitur një fletëvotim të printuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë e pretenduara në 23 (njezet e tri) vendvotimet në Mitrovicë e Veriut, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së Dusan Milunovic nga subjekti G.I. Serpski Opstanak nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 662/2021 më datën 20.10.2021

Kryesuesi i Panelit

Herki Xhatri

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

